Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun

Në rastet kur subjektet e interesuara vlerësojnë se procedurat e konsultimit publik nuk janë zbatuar sipas kërkesave të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ato kanë të drejtë të paraqesin ankesë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ankesa duhet të përmbajë:

- identifikimin e procedurës së konsultimit publik;
- shkeljet e pretenduara procedurale;
- provat ose dokumentet mbështetëse;
- kërkesën konkrete të ankuesit.

Pas administrimit të ankesës, autoriteti kompetent shqyrton pretendimet dhe, kur konstaton shkelje, rekomandon marrjen e masave administrative për korrigjimin e procedurës ose garantimin e të drejtave të publikut.